



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORIA E VLERËSIMIT

**NJOFTIM**

**PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR PROVIMIN PËR KATEGORINË E  
KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE**

Për të gjithë kandidatët aplikantë për provimin me shkrim për kategoritë e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2019-2020, ju bëjmë me dije se provimi do të zhvillohet në datat 20, 21, 22, 23 dhe 24 korrik 2020, ora 10.00 deri më 12.30.

Kalendari dhe listat emërore, me oraret përkatëse për çdo kandidat, do të publikohen në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al).  
Provimi për kategorinë e kualifikimit të mësuesve do të zhvillohet në institucionet arsimore: gjimnazi “Ismail Qemali” dhe shkolla 9-vjeçare “1 Maji, në Tiranë.

*Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe në vijim të masave parandaluese të përhapjes së tij, nëpërmjet urdhrave të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, provimi do të zhvillohet duke zbatuar me përpikmëri rregullat e mëposhtme:*

*Kandidati duhet të respektojë rregullat e distancimit fizik dhe të higjienës.*

*Në ditën e provimit, secili kandidat duhet të mbajë detyrimisht maskë dhe doreza dhe të respektojë distancimin fizik.*

*Të gjithë personat e përfshirë në administrimin e procesit të kualifikimit të mësuesve, të kenë detyrimisht maskë dhe doreza gjatë gjithë procesit dhe të respektojnë distancimin fizik.*

*Mjediset ku do të zhvillohen provimet e kualifikimit të mësuesve të jenë, të ajrosura, të ndriçuara dhe të dezinfektuara.*

*Personi i caktuar nga QSHA, kryen për çdo kandidat procedurën si më poshtë:*

- i. mat temperaturën në ballë me termometër digjital.*
- ii. kontrollon nëse çdo kandidat është i pajisur me maskë dhe doreza.*

*Gjatë paraqitjes për pjesëmarrje në provim, kandidati duhet të ketë parasysh dhe të zbatojë rregullat e mëposhtme:*

- 1. të paraqitet i pajisur me mjetet mbrojtëse, maskë dhe doreza plastike;*

2. të zbatojë ruajtjen e distancës fizike 1,5 metër nga kandidatët e tjerë;
3. të jetë i pasjiur me dokument identifikimi;
4. të mos ketë me vete celular, çantë dhe sende të tjera personale të panevojshme për zhvillimin e provimit.
5. Kandidati duhet të paraqitet së paku **30 minuta përpara** fillimit të provimit.
6. Kandidati duhet të mbajë parasysh sa më poshtë:
  - Të mos **mbajë** dhe **të mos përdorë celular** dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi ky vlerësohet si kriter skualifikimi;
  - Ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit;
  - Ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit.

Për të gjithë kandidatët e regjistruar, lutemi të verifikoni paraprakisht emrin, mbiemrin, lëndën, si dhe ditën e provimit në faqen zyrtare të QSHA-së, në adresën [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al),

*Ju urojmë Suksese!*